

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 21 PRILL 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Ju, demokratë,

Unë e kam aq edukatë familjare, dhe jo vetëm, që të mos ua jap kënaqësinë këtyre mbrapa për skenat që ndodhën. Ne mund të kemi pasur probleme, dhe kemi probleme me nesh, por kurrë, asnjëherë e vetmja gjë që nuk duhet të bëjmë është t'i japim kënaqësinë atij që iku. Apo është këtu?! Këtu qenka! Ky është njeriu, i cili vjen këtu thjesht dhe vetëm për të bërë provokime për atë që erdhi këtu dhe e zuri foltoren me forcë. Ky nuk ka asnjë skrupull, thjesht dhe vetëm do të ngjashmin e tij. Kaq! Do të ngjashmin e tij edhe për një nga proceset më të rëndësishme, siç është zgjedhja e Presidentit. Në fakt, marrëveshja midis këtij dhe atij është e vitit 2008. Kaq e thjeshtë! Ky nuk e fsheh aspak çfarë do të bëjë në kurriz të shqiptarëve; është e qartë për të gjithë.

Siç ka bërë me të gjitha pushtetet, kështu do të bëjë edhe me Presidentin e Republikën, është fare e thjeshtë. Nuk ka këtu të madh dhe të vogël që nuk e kupton këtë gjë. Në fakt, shqiptarët do të duan të kuptojnë pse e bën këtë. Cila është arsyeja?! Cili është shkaku që e bën këtë gjë?! Është i thjeshtë: standardet morale dhe politike që kjo pjesë e parlamentit tashmë i ka bërë. A është burrë ky, a do të krijojë një aureolë dhe një proces të përzgjedhur për të parin e shqiptarëve?! Po le të flasë një herë për ata deputetët e tij. Dy i ka në qeli, dy të tjerëve nuk guxon as t'u përmendë emrin. Ky ka marrë 74 vota, ka vjedhur 74 mandate?! Dy i ka në qeli; ky nuk guxon as të mbajë më minimumin e standardit, të distancimit, atë që ne kemi bërë, atë që shqiptarët e duan dhe që Departamenti i Amerikan i Shtetit ia dha me të shkruar e zeza mbi të bardhë. Pra, filloje nga vetja! A do të jesh i besueshëm? A do ta kalosh ylberin? Bëj këtë gjë. Je Kryeministri i vendi ti?! Bëjeni këtë gjë, tregojeni. Keni vjedhur mandate? Po, por nuk keni legjitimitimin e shqiptarëve. Kjo është e rëndësishme. A do ta zgjedhësh Presidentin tënd?

Mund ta bësh pse lodhesh kot me zarfe; fut në zarfe, turp i madh, qesharak! Kujt po i hedh hi syve?! Shqiptarëve?! Gjasme po i pyet ti! Po konsultohesh ti me shoqërinë civile? Ti çfarë nuk bërë një vit më parë, me patronazhistë, me krimin e organizuar, me gjithë shtetin në betejë, vjen këtu për të treguar që do të zgjedhësh Presidentin, pushtetin neutral, ti zemërmadhi! Bëje këtë, si shenja e parë, (pendesë e di që nuk ke), e sinqeritetit në këtë proces. Ti duhet të kuptosh një gjë: ne vërtet mund të jemi sot në një situatë jo të mirë, por mos harroni një gjë: kurrë nuk ke për t'ia arritur... Këta njerëz këtu janë shpirtra të lirë, nuk kanë skelete në dollap, nuk janë si këta të tutë që i detyron si "dele", ndjesë, me një zarf, nga tre emra për çdo zarf. Çfarë do të thotë kjo?! Presidentin e zarfit?! Mund t'i kesh, nuk do të kesh asnjë lloj problemi nga këta, fare, por një detyrimin ndaj shqiptarëve. Ne e kemi detyrimin ndaj shqiptarëve, të paktën ndaj gjysmës së shqiptarëve, që na votuan. Unë e di që me ato mandate për shkak të 21 prillit 2008, për shkak të marrëveshjes, po, ti e merr, e merr, mos i lodhni njerëzit.

Ne kemi detyrimin që gjithë këtë farsë me zarfe dhe me gjëra të ta grisim. Nuk jemi ne nga ata që i bishtnojmë betejës, beteja jonë nuk është për të zgjedhur emrin, kuptojeni këtë gjë. Beteja jonë është që të dalim para shqiptarëve për cilat janë kërkesat, profili dhe nevojat që duhet të kenë shqiptarët për një President jo partiak që të qëndrojë me vlera morale dhe që ka treguar në të shkuarën që nuk bëhet vegël e askujt. E bën dot ti këtë?! Ke ti kaq mundësi ta kalosh ylberin?! Jo, nuk e bën dot, sepse duhet të bësh atë të parin që të thashë. Jepini, zgjidhje Departamentit Amerikan të Shtetit, i ka rrëzuar zgjedhjet, i ka rrëzuar edhe numrat që keni këtu. Ti do të zvarritesh, do t'i mbash, siç ke bërë gjithmonë, pra kjo është situata. Edukata ime familjare dhe e të gjithëve këtyre, që janë shpirtra të lirë, nuk janë vegël e askujt këtu, i shikojnë njerëzit në sy, e kanë kokën lartë, nuk kanë pengje të së shkuarës dhe do t'u japin procesin më të mirë shqiptarëve, pavarësisht rezultatit.

Rezultatin e dimë të gjithë, por kini parasysht që jeni përballë edhe ca gjërave të tjera jo vetëm lojës së vogël meskine që bën këtu gjithmonë: flet njëri, vjen këtu dhe zini foltoren, ti vazhdon jo i gjallë dhe jo i vdekur. Ti ke ngelur peng, ka ikur koha, por keni disa detyrime të tjera ndaj atyre që na shikojnë dhe na monitorojnë, që e duan këtë vend dhe duan ta ndihmojnë këtë vend dhe ta nxjerrin nga vorbullat korruptive dhe kriminale ku ti e ke futur. Ne kësaj do t'i qëndrojmë të qetë, në bazë të moralit politik, duke u shërbyer shqiptarëve. Kështu do të na kesh, përballë! Ne e dimë, jemi përballë sulmeve nga të gjitha anët, po, po. Kjo është ajo që ty nuk të vjen mirë, këtë nuk e kapërcen dot ti, këtë nuk e merr dot ti me tallje dhe me fyerje, këtu të ngec sharra në gozhdë! Miq, demokratë, kurrë nuk do të shikoni, asnjëherë, unë jo e jo, por asnjë nga kolegët e mi që t'i japin kënaqësinë perverse këtij njeriu këtu për të bërë shfaqje të shëmtuara, siç bëri.

Ai ka zgjidhjen e tij, ne kemi bërë zgjidhjen tonë. Po, me dhimbje, e di fare mirë, me kosto, sigurisht, por më mirë me shpirtra të lirë, t'ju shikojmë në sy për gabimet që kemi bërë, por edhe për sfidën që kemi të gjithë së bashku para, demokratët të parët dhe shqiptarët e ndershëm, shqiptarët e punës, shqiptarët që kanë dinjitet, shqiptarët e sakrificës dhe të djersës. Ne këtë do të bëjmë, mbase të vetëm, por më mirë vetëm se sa me pengje të së shkuarës. Kjo është qasja që do të mbajë grupi parlamentar, besoj dhe uroj në këtë proces, pa komplekse, pa u tërhequr, pa u bërë pjesë e asnjë lloji loje meskine, siç ky do të bëjë. Zarfet t'i mbajë për vete! Ky le të zgjidhë hallin e tij me ata që ka te "313-ta" dhe me ata që do shikojnë te "313-ta". Ky nuk është halli shqiptarëve. Jo, shqiptarët kanë tjetër hall dhe problem tashmë prej 9 vjetësh. Sot ne mund të dukemi sikur jemi pak, por forca e shembullit, modeli dhe morali, kjo është mënyra e vetme se si mund të bëjë shumicën dërrmuese të shqiptarëve të ndershëm përballë kësaj situatë të pështirë! E ndieni edhe ju të gjithë, por nuk keni gojë të flisni, mbase jo të gjithë jeni në gjendjen e këtij.

Keni vendosur dorën në Kushtetutë, përbetoheni për shqiptarët, nuk gjeni dot guxim, ju përdor thjesht dhe vetëm si numra, merrni zarfe, mbushni zarfe! Miqtë e mi, ne duhet të jemi krenarë për atë që kemi bërë deri tani, çfarë kemi bërë deri tani dhe çfarë do të bëjmë më pas, të gjithë bashkë, me kokën lart dhe pa asnjë peng. Ky është shërbimi që duhet t'u bëjmë shqiptarëve, të cilët na votuan; për këtë na votuan shqiptarët, edhe pse ky na i vodhi votat. Po, është mënyra e vetme se si të jemi të nderuar sot dhe nesër. Jeta është e gjatë, historia do të shkruhet, e nesërmja do të jetë gjykimi ynë i historisë, i demokratëve dhe i shqiptarëve. Kush ka qëndruar sot, kush ka dalë përballë sfidave? Kjo që po ndodh në këtë parlament është sfidë morale, për këtë do të vlerësoheni dhe për këtë do të gjykojeni. Lojërat e së

shkuarës le të ngelen të së shkuarës. Shqiptari këtë duhet të bëjë: të refuzojë me neveri atë se çfarë ndodh këtu.

Kjo lojë do të vazhdojë edhe për ca kohë të tjera, sepse ky për ekonominë s'flet dot, për papunësinë s'flet dot, për krimin s'flet e s'flet dot, për mungesën e shpresës as që nuk flet dot, për shqiptarët që ikën, jo e jo. Ky bën lojëra dhe i ka dalë boja me kohë e me vakt, por ju të tjerët shpëtoni shpirtrat tuaj dhe mos e lini t'ju tërheqë prej hunde, ruani dinjitetin, sepse ne këtej e kemi bërë dhe jemi ballëllartë para shqiptarëve. Kjo është gjëja! Ti mund të mos jesh përballur ndonjëherë me këtë lloj qasjeje dhe mund të duket një gjë e re, kaluar ylberin, je mësuar me lojëra, me zarfe, me pazare, më jep këtë dhe të jap atë, por nuk ke për ta pasur më këtë luks, fare. Ti je i vetëm, mund të gjesh edhe ndonjë tjetër, por çdo gjë që do të gjesh është e së shkuarës, siç je edhe ti, fosile të politikës kanë mbetur ende në këtë parlament. Detyra e shqiptarëve dhe e vetmja është që të bëjnë pikërisht këtë gjë: ndarjen me të shkuarën. Shqipëria është e njerëzve të punës dhe të nderit, nuk është juaja. Faleminderit!